

Në bazë të nenit 17 parag.1, nenit 20 parag.1 alinea 1 dhe nen.25 të Ligjit për Administratë Gjyqësore (“Gazeta Zyrtare e RM”, nr.43/14, 33/15, 98/15, 6/16, 198/18, 248/18 dhe G. Zyrtare të RSM nr.235/22), të nen.2 të Rregullores për formën dhe përmbajtjen e konkursit publik, të formës, përmbajtjes dhe mënyrës të paraqitjes së aplikimit, të realizimit të selektimit administrativ të provimeve, kontrollimit të besueshmërisë së dëshmive dhe intervistës, si dhe të mënyrës së rangimit të tyre dhe numrit maksimal të pikëve nga procedura e selektimit në varësi të kategorive të vendeve të punës si dhe çështjeve të tjera lidhur me procedurën e punësimit të nëpunësve gjyqësor (G. Zyrtare e RM nr.236/18), të Rregullores për organizimin dhe sistematizimin e brendshëm të vendeve të punës në Gjykatën Themelore Dibër, AGJ nr.90/2015 datë 16.03.2015, të Dakordimit nga Këshilli Gjyqësor Buxhetor nr.119/7 datë 14.03.2023, Gjykata Themelore Dibër me datë 15.03.2023 shpall:

### **KONKURS PUBLIK nr.1/23**

Për punësimin e nëpunësit gjyqësor në kohë të pacaktuar për vendin e punës si në vijim:

**Referent i lartë gjyqësor – arkivist, Kategoria G. niveli G2, shifra e vendit të punës SUD0101G02001..... 1 (një) kryerës.**

**Kushtet e veçanta** - kualifikime dhe kompetenca të nevojshme profesionale:

- të ketë së paku arsimin e mesëm ose të lartë të lëmisë përkatëse,
- të ketë më së paku dy vjet përvojë pune në profesion,
- njohje aktive të njërës nga tri gjuhët më të përdorura në UE (angleze, franceze, gjermane) dhe
- njohje aktive të programeve kompjuterike për punë në zyrë.

-Paga bazë e vendit të punës do të jetë 20.986,00 denarë.

Përpos kushteve të veçanta, kandidatët për vendin e punës është e nevojshme që t'i plotësojnë dhe **kushtet e përgjithshme** vijuese:

- të jetë shtetas i Republikës së Maqedonisë së Veriut;
- të përdorë gjuhën maqedone në mënyrë aktive;
- të jetë i moshës madhore;
- të ketë aftësi të përgjithshme shëndetësore për vendin e punës;
- me aktgjykim gjyqësor të plotëfuqishëm të mos i jetë shqiptuar dënim ndalesë për kryerjen e profesionit, veprimtarisë ose detyrës.

Te drejta dhe obligime të tjera për vendin e punës:

- Orë pune: 40 orë në javë
- Ditë pune: e hënë - e premte;
- Orari i punës nga ora 7:30 deri në orën 15:30.
- Pushimi ditor: nga ora 11.00 deri në orën 11,30.

Kandidatët e interesuar janë të detyruar që të paraqesin aplikimin e plotësuar për punësim të nëpunësit gjyqësor (formular i shpallur në Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë nr.236/18) me dëshmi për plotësimin e kushteve të përgjithshme dhe të veçanta për vendin e punës për të cilin paraqiten në original ose kopje të vërtetuar te noteri:

- Vërtetim për kryerjen e arsimit përkatës,
- Dëshmi për përvojë pune,
- Çertifikatë për nënshtetësi,
- Vërtetim mjeksor për gjendjen e përgjithshme shëndetësore,
- Vërtetim ose çertifikatë se me aktgjykim të plotfuqishëm gjyqësor nuk i është shqiptuar dënimi me ndalim të kryerjes së profesionit, veprimtarisë ose detyrës.

Literatura e nevojshme për provim dhe Aplikimi për punësim mund të merren në veb faqen e gjykatës [www.osdebar.mk](http://www.osdebar.mk)

Aplikimi i plotësuar së bashku me dëshmitë për plotësimin e kushteve të përgjithshme dhe të veçanta në original ose në kopje të vërtetuar te noteri mund të dorëzohen në sportelin e pranimit të gjykatës ose nëpërmjet postës në adresën: Gjykata Themelore Dibër, rr. “Velko Vllahoviq” pn Dibër, me shënimin “Për konkursin publik nr.1/23”.

Afati i aplikimit është 15 (pesëmbëdhjetë) ditë llogaritur nga dita e publikimit të fundit të konkursit në shtypin ditor (dita e shpalljes së konkursit nuk llogaritet).

Procedura e selektimit dhe punësimit do të realizohet në pajtim me Rregulloren për formën dhe përmbajtjen e konkursit publik, formën, përmbajtjen dhe mënyrën e paraqitjes së aplikimit, realizimit të selektimit administrativ të provimeve, kontrollimit të besueshmërisë së provave dhe intervistës, si dhe mënyrën e rangimit të tyre dhe numrit maksimal të pikëve nga procedura e selektimit në varësi të kategorive të vendeve të punës si dhe çështjeve të tjera lidhur me procedurën e punësimit të nëpunësve gjyqësor (G. Zyrtare e RM nr.236/18).

Kandidatët të cilët japin të dhëna të rrejshme në aplikim do të diskualifikohen nga procedura e mëtejshme.

Kandidatët të cilët do të kalojnë selektimin administrativ do të kenë provim me shkrim në hapësirat e Gjykatës Themelore Dibër.

Koha dhe data e mbajtjes së selektimit administrativ, provimi dhe intervista do të shpallen në veb faqen e Gjykatës Themelore Dibër.

GJYKATA THEMELORE DIBËR  
KRYETAR  
MERSIM MARKU